



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.07

Prishtinë, më 16.1.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S- I

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Munguan:** Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, Nezir Çoçaj dhe Verica Qeraniq.

**Përfaqësues të tjerë:** Shefki Kastrati – NDI dhe përfaqësues të medias.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.12.2017;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2018;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.12.2017**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 13.12.2017, u miratua me propozimin e kryetarit, që përgjigjet e ministrave në çështjet e ngritura të anëtarëve të komisionit, të përfshihen në procesverbal, si dhe vërejtjen e deputetes Teuta Haxhiu rreth kontestit të fjalisë në diskutimin e saj.

### **3. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2018**

Kryetari i komisionit, në fillim të mbledhjes, tha se në planin e punës për vitin 2018, parashihet shqyrtimi i disa projektligjeve nga ana e MASHT, ndërsa MKRS nuk ka paraparë të procedojë ndonjë projektligj për këtë vit kalendarik, ndërkaq plani i punës mund të pësojë edhe ndryshime dhe plotësime gjatë vitit.

Sa i përket MIN, tha se në diskutimet e mëhershme të anëtarëve të komisionit, vërehet që fushëveprimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, nuk ka të bëjë me komisionin, andaj kërkoj që të diskutohet dhe të merret një qëndrim, në mënyrë që kjo ministri të bartet në komisionet tjera të Kuvendit.

**Teuta Haxhiu**, tha se ndër objektivat e komisionit për vitin 2018, është shqyrtimi i projektligjit për Inspektoratin e Arsimit, i cili do të ndikojë në ngritjen e cilësisë në arsim, për shkak se kemi numër të vogël të inspektorëve në komuna të caktuara. Sa i përket çështjes së bartjes së MIN në ndonjë komision tjetër, tha se e ndan mendimin lidhur me këtë, për arsye se ka elemente që komision ynë mund të përfshihet, ndërsa propozoi që në mbledhjet e radhës të ftohet ministri, me qëllim të raportimit lidhur me hapat e ndërmarra deri më tani në themelimin e qendrave inovative. Po ashtu, ngriti edhe çështjen e Agjencisë për Akreditim dhe propozoi që të ftohet ministri i MASHT për të dhënë informata për kompletimin e bordit për universitetet publike, regjistrimin e studentëve nëpër kolegjet private, të cilat po ndodhin edhe në këtë fazë, çështjen e mësimdhënësve të diplomuar në kolegje private dhe me këtë rast kemi shkelje të Ligjit për arsimin e lartë.

**Arbërie Nagavci**, tha se lidhur me çështjen e ngritur, rreth përfshirjes së Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në fushëveprimin e komisionit, mendon se edhe përkundër disa çështjeve që janë me interes, edhe për ne si komision, mendon se për shkak të volumit të madh të punëve në fushën e arsimit dhe të kulturës, është e pajtimit që kjo ministri mund të bartet në ndonjë komision tjetër parlamentar.

Sa i përket planit të punës, ku theksohen vizitat nëpër institucione arsimore, propozoj që para se të realizohen këto vizita, ne të përcaktojmë fokusin tonë dhe çështjet që janë me interes, qoftë në implementimin e kurrikulës të shkollat fillore dhe të e mesme të ulëta apo tek cilësia në arsim dhe me të dalim me përfundime konkrete, pas realizimit të këtyre vizitave. Po ashtu, ngriti edhe

çështjen e moskompletimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Akreditimit. Më tutje, ngriti çështjen e deklarimit të ministrit të MASHT, rreth testim të mësimeve dhe profilizimit të tyre, andaj lidhur me këtë propozoi që në rastet kur të ftohet ministri, për të raportuar për një çështje, paraprakisht të na dërgojë raport me shkrim.

Sa i përket Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, tha se nga takimi i fundit që kishim me anëtarët e këshillit, u vërejt një mospajtim mes tyre dhe propozoj që të bëhet një vizitë në këtë institucion, në mënyrë që të informohemi me mbarëvajtjen e punës në këshill.

**Ismajl Kurteshi**, lidhur me çështjen e ngritur rreth Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, propozoi që të formohet një grup punues, në përbërje: Teuta Haxhiut, Arbërie Nagavci dhe Albulena Balaj-Halimaj, për të realizuar një vizitë pune në këtë këshill, me qëllim të marrjes së informatave rreth funksionimit të tij.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me propozimin për formimin e grupit punues.

**Mufera Shinik**, propozoi që në planin e punës për vitin 2018, tek objektivat, ku fitet për bashkëpunimin e komisionit me organizatat ndërkombëtare, të përfshihet edhe TIKA, në mesin e organizatave tjera.

**Ismajl Kurteshi**, tha se plani i punës për vitin 2018, do të plotësohet me propozimet që u dhanë sot nga anëtarët e komisionit, si dhe do të përcaktoheni për ligjet që do t'i mbikëqyrin. Andaj, meqë në mbledhje mungojnë sot disa nga anëtarët, propozoj që miratimi i planit të punës të bëhet në mbledhjen e radhës.

#### **4. Të ndryshme**

Ismajl Kurteshi, tha se në mbledhjen e datës 23.1.2018, do të ftohet ministri i MASHT-it, z. Shyqiri Bytyçi, për të diskutuar lidhur me Vendimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë e Akreditimit, si dhe gjendjen në arsimin e lartë.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që të premten, më datë 19.1.2018, të mbahet takim me organizatat e shoqërisë civile, pjesë të Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet, për të diskutuar lidhur me të gjeturat dhe zhvillimet e fundit në arsimin e lartë.

Gjithashtu, komisioni u pajtua që nga java e ardhshme, të fillohet me vizita pune në shkollat profesionale.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

***E përgatiti:***

***Stafi mbështetës i komisionit.***

Kryetari i komisionit,

-----  
Ismajl Kurteshi